



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Indeksi i Çmimeve të Prodhimit TM3 2020**



## **P a r a t h ë n i e**

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikoj Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) në maj 2009.

Çmimet dhe vlerat e produkteve industriale mblihen nga ndërmarrjet prodhuese më ndikim më të në Kosovë. Vlera e produktit dhe çmimi mesatar vjetor i referohet vitit 2007 (si vit fillestar), ndërsa që nga tremujori i parë i vitit 2009 indeksi monitorohet dhe llogaritet vazhdimisht në periudha tremujore dhe vjetore.

IÇP, ose Indeksi i çmimeve të prodhimit është në përputhje me Klasifikimin Standard të Aktiviteteve sipas NACE rev.2, bazuar në "Reregulloren Nr.11/2013 neni 7, për zbatimin e Klasifikimit Standard të Aktiviteteve.

IÇP është në ndertim e sipër dhe vazhdimisht kërkon të përfshijë aktivitete ekonomike të cilat aktualisht nuk janë aktive, por gradualisht produkti pritet nga këto aktivitete.

Sugjerimet, komentet, propozimet dhe vërejtjet në lidhje me këtë botim mund të dërgohen në: [economic@ks-gov.net](mailto:economic@ks-gov.net).

Ky publikim është përgatitur nga:

Ismail Sahiti – Z.v Drejtor i Departamentit

Ibish Asllani - Shef divizionit

Hamdi Jupolli - Shef Sektori

Hasan Berisha-Zyrtar i lartë

Dhjetor 2020

Z.v Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,

Ilir T. Berisha

## Simbolet dhe Shkurtesat

IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NVE	-	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
TM1	-	Tremujori i parë
TM2	-	Tremujori i dytë
TM3	-	Tremujori i tretë
TM4	-	Tremujori i katërt
:	-	Shfra nuk është disponibël
0	-	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	-	Nuk aplikohet
%	-	Përqindje
W	-	Ponderët statistikor (pesha specifike)
∅	-	Mesatare

## **P ë r m b a j t j a**

	Faqe
Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për tremujorin e trtë - 2020.....	4
Tabela 1: Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) TM1 2009 – TM3 2020 (2010=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje .....	5
Tabela 2: Peshat, indeksi i çmimeve të prodhimit (2010=100) dhe ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje .....	7
Metodologjia .....	8

## **Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për tremujorin e trtë - 2020**

Indeksi i tërsishem i çmimeve të prodhimit në Kosovë u ngriten 1.3% mes të TM3 2020 krahasuar TM2 2020. Krahasuar me TM3 2019 çmimet e prodhimit pësuan rënie në një mesatare prej - 0.8%.

### **Tremujori i trtë 2020 – Tremujori i dytë 2020 1.3%**

Çmimet e prodhimit në Kosovë u ngriten në një mesatare prej 1.3%, në mes TM3 2020 dhe TM2 2020. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (44.4%), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (2.6%), prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (1.8%), prodhimi i pijeve (0.8%), prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (0.6%), prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (0.5%), prodhimi i produkteve minerale jo metalike (0.4%), përpunimi i produkteve ushqimore (0.4%) dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara – thurëse (0.1%).

Ngritja u neutralizua me rëniën e çmimeve te: prodhimi produkteve të gomës dhe të plastikës (-1.0%), prodhimi produkteve kimike (-0.5%), xeheroret dhe guroret tjera (-0.3%), prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (-0.1%) dhe prodhimi i mobilieve (-0.1%).

### **Tremujori i tretë 2020 – Tremujori i tretë 2019 -0.8%**


Çmimet e Prodhimit në Kosovë pësuan rënie në një mesatare prej -0.8 % në mes të TM3 2020 dhe TM3 2019. Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: prodhimi i produkteve minerale jo metalike (-5.0%), prodhimi i metaleve (-4.9%), prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (-4.6%), prodhimi i mobilieve (-4.4%), prodhimi produkteve të gomës dhe të plastikës (-2.7%), prodhimi i pijeve (-2.5%), prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (-0.5%), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-0.5%) dhe përpunimi i produkteve ushqimore (-0.5%).

Rënia u neutralizua nga ngritja e çmimeve te: prodhimi mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (12.9%), prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (8.5%), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara – thurëse (4.2%), nxjerrja e xehes së metalit (3.9%), prodhimi produkteve kimike (3.0%), prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (2.2%), prodhimi i pajisjeve elektrike (1.5%) dhe xeheroret dhe guroret tjera (0.6%).

**Tabela 1: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) TM1 2009 – TM3 2020 (2010=100),  
Ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje**

Viti	Tremujori	Index (2010=100)	Ndryshimi tremujor në (%)	Ndryshimi vjetor në (%)
2009	TM1	94,9	:	:
	TM2	96,5	1,7	:
	TM3	96,5	0,0	:
	TM4	96,6	0,1	:
	<b>Mesatarja vjetore 2009</b>	<b>96,1</b>	:	:
2010	TM1	97,1	0,5	2,3
	TM2	98,0	0,9	1,6
	TM3	101,1	3,2	4,8
	TM4	103,9	2,8	7,6
	<b>Mesatarja vjetore 2010</b>	<b>100,0</b>	:	<b>4,1</b>
2011	TM1	105,2	1,3	8,3
	TM2	104,5	-0,7	6,6
	TM3	104,4	-0,1	3,3
	TM4	104,2	-0,2	0,3
	<b>Mesatarja vjetore 2011</b>	<b>104,6</b>	:	<b>4,5</b>
2012	TM1	104,6	0,4	-0,6
	TM2	105,8	1,1	1,2
	TM3	107,1	1,2	2,6
	TM4	108,8	1,6	4,4
	<b>Mesatarja vjetore 2012</b>	<b>106,6</b>	:	<b>1,9</b>
2013	TM1	111,3	2,3	6,4
	TM2	109,3	-1,8	3,3
	TM3	106,9	-2,2	-0,2
	TM4	109,0	2,0	0,2
	<b>Mesatarja vjetore 2013</b>	<b>109,1</b>	:	<b>2,4</b>
2014	TM1	109,8	0,7	-1,3
	TM2	109,5	-0,3	0,2
	TM3	110,8	1,2	3,6
	TM4	113,5	2,4	4,1
	<b>Mesatarja vjetore 2014</b>	<b>110,9</b>	:	<b>1,6</b>
2015	TM1	113,7	0,2	3,6
	TM2	114,1	0,4	4,2
	TM3	113,8	-0,3	2,7
	TM4	113,8	0,0	0,3
	<b>Mesatarja vjetore 2015</b>	<b>113,9</b>	:	<b>2,7</b>
2016	TM1	113,2	-0,5	-0,4
	TM2	114,4	1,1	0,3
	TM3	113,8	-0,5	0,0
	TM4	113,7	-0,1	-0,1
	<b>Mesatarja vjetore 2016</b>	<b>113,8</b>	:	<b>-0,1</b>
2017	TM1	114,2	0,4	0,9
	TM2	113,8	-0,4	-0,5
	TM3	114,3	0,4	0,4
	TM4	115,5	1,0	1,6
	<b>Mesatarja vjetore 2017</b>	<b>114,5</b>	:	<b>0,6</b>
2018	TM1	114,4	-1,0	0,2
	TM2	115,7	1,1	1,7
	TM3	116,9	1,0	2,3
	TM4	117,0	0,1	1,3
	<b>Mesatarja vjetore 2018</b>	<b>116,0</b>	:	<b>1,4</b>
2019	TM1	116,8	-0,2	2,1
	TM2	117,0	0,2	1,1
	TM3	117,6	0,5	0,6
	TM4	116,9	-0,6	-0,1
	<b>Mesatarja vjetore 2019</b>	<b>117,1</b>	:	<b>0,9</b>
2020	TM1	116,6	-0,3	-0,2
	TM2	115,2	-1,2	-1,5
	TM3	116,7	1,3	-0,8

**Grafiku1: Zhvillimi i IÇP, Tremujori i parë 2009 –Tremujori i tretë 2020 (2010=100)**



**Tabela 2: Peshat, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (2010=100) dhe ndryshimet Tremujore dhe vjetore në përqindje**

Kodet	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike rev.2	NVE	Peshat	TM3 - 2020	TM3 - 2020	TM3 - 2020
				Ø2010=100	TM2 - 2019	TM3 - 2019
	<b>Gjithsej IÇP</b>		<b>1000,00</b>	<b>116,7</b>	<b>1,3</b>	<b>-0,8</b>
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve		3,66	137,5	0,0	0,0
07	Nxjerrja e xehes së metalit		15,69	195,7	44,4	3,9
08	Xeherorët dhe guroret tjera		25,59	131,9	-0,3	0,6
10	Përpunimi i produkteve ushqimore		139,84	110,5	0,4	-0,5
11	Prodhimi i pijeve		59,52	101,8	0,8	-2,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit		0,34	0,0	0,0	0,0
13	Prodhimi i tekstilit		8,72	0,0	0,0	0,0
14	Prodhimi i veshjeve		3,39	0,0	0,0	0,0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës		4,14	110,5	1,8	8,5
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse		15,02	104,3	0,1	4,2
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës		14,03	80,1	-0,1	-0,5
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara		7,72	0,0	0,0	0,0
20	Prodhimi i produkteve kimike		21,48	137,7	-0,5	3,0
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike		2,66	0,0	0,0	0,0
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës		78,30	98,3	-1,0	-2,7
23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike		148,93	96,8	0,4	-5,0
24	Prodhimi i metaleve		44,65	79,6	0,0	-4,9
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve		68,53	90,9	0,6	2,2
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike		6,22	106,3	0,0	1,5
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t		4,19	87,1	0,0	-4,6
30	Prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove		1,36	127,6	0,5	12,9
31	Prodhimi i mobilie		26,54	96,2	-0,1	-4,4
32	Prodhimi tjetër p.k.t.		2,28	0,0	0,0	0,0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar		267,56	134,9	2,6	-0,5
36	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë		18,18	104,1	0,0	0,0
38	Veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve		11,46	0,0	0,0	0,0



## Definicioni dhe qëllimi i IÇP

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) është tregues relativ që mat shkallën në të cilën çmimet e mallrave (prodhimeve) të prodhuara dhe shërbimeve ndryshojnë në periudha të caktuara kohore. Kryesisht si parametër statistikor ka një rëndësi të veçantë si deflator i Bruto Prodhimit Vendor me qasjen e prodhimit.

## Metodologjia

Çmimet dhe vlera e prodhimeve industriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese më reprezentative në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor janë  $TM_1$  për vitin 2007, ndërsa nga  $TM_1$  për vitin 2009 bëhet grumbullimi i rregullt në kontinuitet për çdo tremujor.

Për shkak të krahasueshmerise së të dhënave me të dhënat e Eurostatit, me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës që nga 01/09/2014 ka filluar të përdorë nomenklaturen e re të aktiviteteve ekonomike (NACE Rev.2) bazuar në “Rregulloren Nr.11/2013 për implementimin e standartit për klasifikimin e veprimtarive” kështu që edhe Indeksi i çmimeve të prodhimit ka pësuar ndryshime në përputhje me këtë nomenklaturë.

Njëherit edhe Indeksi bazë ka pësuar ndryshime duke kaluar nga viti bazë 2007=100 në vitin bazë **2010=100**. Në llogaritjen e këtij indeksi nuk merrin pjesë Ndarjet 12, 13, 14, 18, 21, 32 dhe 38 marrin pjesë në llogaritjen e Indeksit, por për shkak se çmimet për keto Ndarje kanë filluar të grumbullohen pas vitit 2010 dhe u mungon indeksi bazë 2010=100 e që me vonë do t'u krijohet indeksi bazë dhe do të llogariten edhe këta indikatorë.

Që nga viti 2020, IÇP është i llogaritur për 26 Ndarje (aktivitete ekonomike), 197 ndërmarrje prodhuese mbi 800 (konkretisht 807) artikuj. Si projekt (GOPA - ASK) ka filluar gjatë vitit 2007 me qëllim që të krijohet baza elementare për themelimin e hulumtimit të IÇP-se, ndërsa nga mesi i vitit 2010 projekti është duke u mbështetur nga SIDA suedeze.

IÇP nga tremujori i parë 2020 përdorë peshat specifike të rifreskuara nga të dhënat e Anketës Strukturore të Bizneseve (ASN), viti 2018.

Për llogaritjen e IÇP-se është përdorë formula e Lasperit

Agregimi deri në IÇP në tërësi

$$PPI_0^q = 100 * \sum_{g=1}^h w_g * I_{0,g}^q$$

$PPI_0^q$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit në mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

$w_g$  = Pesha për grupe

$I_{0,g}^m$  = Shkalla e çmimit për grupin g mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

$h$  = Numri i aktiviteteve ekonomike sipas NACE Rev2.

**Llogaritja e indeksit zingjiror të IÇP**

$$PPI_{2010}^{Y,q} = \frac{PPI_{2010}^{Y-1,4}}{100} * PPI_0^{Y,q}$$

$PPI_{2010}^{Y,q}$  = Indeksi zingjiror i IÇP mes 2010 dhe tremujorit q në vitin aktual

$PPI_{2010}^{Y-1,4}$  = Indeksi zingjiror i IÇP mes 2010 dhe tremujorit të katërt në vitin paraprak

$PPI_0^{Y,q}$  = Indeksi i Çmimit të prodhimit mes tremujorit 0 dhe tremujorit q në vitin aktual

**Llogaritja e ndryshimeve**

Ndryshimi në mes tremujorit q dhe tremujorit q-1 është kalkuluar si vijon:

$$\left[ \left( \frac{PPI_0^{Y,q}}{PPI_0^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Përqindja e ndryshimit tremujor}$$

$PPI_0^{Y,q}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin aktual q

$PPI_0^{Y,q-1}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin paraprak q-1

**Ndryshimi vjetor kalkulohet si :**

$$\left[ \left( \frac{PPI_{2010}^{Y,q}}{PPI_{2010}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Përqindja e ndryshimit vjetor}$$

$PPI_{2010}^{Y,q}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për tremujorin aktual q

$PPI_{2010}^{Y-1,q}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për vitin dhe tremujorin paraprak q

# Agjencia e statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;*** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruarë terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>